

**LIDHJA NR. 2****REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE TË SHISH**

<b>Nr</b>	<b>Data e rregjistrimit të kërkesës</b>	<b>Objekti</b>	<b>Data e kthimit të përgjigjes</b>	<b>Statusi i kërkesës</b>	<b>Tarif a</b>
<b>1.</b>	13.11.2014	Vënie në dispozicion të dokumentacionit mbi numrin e personave të vendosur nën përgjim në periudhën 01.01.2014-31.10.2014 në RSH.	<p><b>Nr.33/1,</b> <b>dt.19.11.2014 -</b> <b>“Kthim përgjigje”</b></p> <p>Informacioni është i klasifikuar “sekret shtetëror”, nuk mund t’ju vihet në dispozicion.</p> <p><b>Nr.147/2,</b> <b>dt.4.2.2015 -</b> <b>“Kthim përgjigje”</b></p> <p>SHISH ka filluar procedurat e rishikimit të klasifikimit në zbatim të nenit 17/5 të ligjit nr.119/2014.</p> <p><b>Nr.143,</b> <b>dt.2.3.2015 -</b> <b>“Kthim përgjigje”</b></p> <p>Komisioni i Deklasifikimit dhe</p>	Nuk mund të vihen në dispozicion në zbatim të vendimit të Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të SHISH.	Nuk ka tarifë

			Zhvlerësimi i SHISH nuk i deklasifikon këto dokumente.		
<b>2.</b>	22.01.2015	Kopje e urdhrit të lirimit.	<p><b>Nr.108/1, dt. 28.01.2015 - “Kthim përgjigje”</b></p> <p>SHISH ka filluar procedurat e rishikimit të klasifikimit në zbatim të nenit 17/5 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.</p> <p>SHISH me <b>Vendimin Nr.2/1, dt.12.2.2015</b> të Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit ka vendosur të mos e deklasifikojë këtë dokument.</p>	Nuk mund të vihet në dispozicion palës së interesuar, në zbatim të vendimit të Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të SHISH.	Nuk ka tarifë

3.	29.3.2016	<p>Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit:</p> <p>1. Analizën vjetore të Sigurimit për vitet 1980-1989</p> <p>2. Shifrën e personave të ndjekur, lidhur me figura të ndryshme armiqësore gjatë periudhës 1980-1989, Dosje 2A.</p>	<p><b>Nr.210/1, dt. 31.3.2016 - “Kthim përgjigje”</b></p> <p>Është Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit, organi kompetent për vënien në dispozicion të këtyre dokumenteve. SHISH në zbatim të ligjit nr.8043, datë 30.11.1995 “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik” është vetëm fondruajtës.</p> <p><b>Nr. 462, dt.6.7.2016 - “Kthim Përgjigje”</b></p> <p>SHISH ka filluar procedurat e rishikimit të klasifikimit dhe po e trajton kërkesën sipas përcaktimeve të nenit 17/5 të ligjit nr.119/2014.</p>	<p>Nuk mund të vihen në dispozicion palës së interesuar, në zbatim të vendimit të Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të SHISH.</p>	Nuk ka tarifë
----	-----------	--	---	---	---------------

			<p><b>Nr.462/1, dt.8.8.2016 – “Mbi kërkesën e palës së interesuar”</b></p> <p>1. Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit në SHISH nuk e deklasifikon dokumentacionin në lidhje me Analizën vjetore të Sigurimit për vitet 1980-1989.</p> <p>2. Kurse shifrën e personave të ndjekur lidhur me figura të ndryshme armiqësore gjatë periudhës 1980-1989, Dosje 2A, nuk janë në Arkivin e SHISH. Kërkesa i drejtohet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivit të Shtetit, në zbatim të nenit 12 të ligjit 119/2014.</p> <p><b>Nr.462/4, dt.09.09.2016 - “Kthim përgjigje”</b></p>	<p>Ministria e Punëve të Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivit të Shtetit, kanë kthyer përgjigje, të cilat SHISH ia ka adresuar palës së interesuar.</p>	
--	--	--	---	---	--

			I janë dërguar palës së interesuar, përgjigjet e ardhura nga MPB dhe DPASH		
4.	8.9.2016	<p>Kërkesë për vënie në dispozicion të:</p> <p>1.Kopje urdhri lirimi nga SHISH;</p> <p>2. Kopje të dokumentacionit të dosjes së procedimit disiplinor nga Komisioni i Disiplinës në SHISH</p>	<p><b>Nr.622, dt.14.9.2016 - “Kthim përgjigje”</b></p> <p>SHISH ka filluar procedurat e rishikimit të klasifikimit dhe po e trajton kërkesën sipas përcaktimeve të nenit 17/5 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.</p>	Ëshë në procedurë rishikimi për deklasifikim	Nuk ka tarifë